



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU-DEJES

V E N D I M

Nr. 64, Datë 30/12/2016

Për

Miratimin e numrit të punonjesve dhe nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, nepunesit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau-Dejes për vitin 2017

Mbështetur në nenin 53 pika 2, nenin 54 germa ç, e Ligjit Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin Nr.9936 datë 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"; në Ligjin Nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017"; Ligjin Nr.10405 datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve"; Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar; VKM Nr.165 datë 02.03.2016 "Per grupimin e njesive te vetëqeverisjes vendore ,per efekt page ,dhe caktimin e kufijeve te pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar ,te nepunesve civile e te punonjesve administrative te njesive te vetëqeverisjes vendore"; VKM nr.624 date 24.07.2013 "Per nje ndryshim ne vendimin nr.194 date 22.04.1999 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e struktures se pages se punonjesve mesimor ne arsimin parauniversitar " te ndryshuar; VKM nr.610 date 24.07.2013 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.717,date 23.06.2009 te Keshillit te Ministrave "Per pagat e punonjesve mbeshtetes te institucioneve buxhetore " te ndryshuar; VKM Nr.965 datë 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave"; Ligjin nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri",ne VKM nr.618 date 24.07.2013 'Per pagat e punonjesve te policise se mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit "te ndryshuar, , Keshilli i Bashkise, pasi shqyrtoi dhe diskutoi materialin e paraqitur ,në mbledhjen e tij të datës 30.12.2016 me shumice votash :

V E N D O S I :

1. Të miratojë numrin maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, nepunesit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau-Dejes për vitin 2017, si më poshtë vijon:

- Numri maksimal i punonjësve është 361 punonjës nga të cilët:

- Numri i punonjësve për administratën është 134 dhe niveli i pagave sipas lidhjes 1.

- Numri i punonjësve për konviktin është 15, dhe niveli i pagave sipas lidhjes 2.

- Numri i punonjësve për Qendrën Rezidenciale është 15, dhe niveli i pagave sipas lidhjes 3.

- Numri i punonjësve të shërbimeve është 135, dhe niveli i pagave sipas lidhjes 4.

- Numri I punonjesve te te qendres kulturore te femijeve eshte 9 sipas lidhjes 5.

- Numri I punonjesvete "Mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi "PMNZSH eshte 14 sipas lidhjes 6

- Numri I punonjesve per arsimin parashkollor (kopshte femijeve)dhe arsimi I mesim 39.



Niveli i shpërblimit për këshilltarët , nderlidhesin komunitare dhe për kryetarët e fshatrave është është sipas lidhjes nr.7.

2. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 01/01/2017 deri me datë 31/12/2017.

3. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.


4.Fondi i pagave perballohet nga transfertat dhe te ardhurat .

5.Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 te ligjit 139/2015.

6.Ky vendim u shpall me date/3.01.2017

SEKRETARI

Gentian Ndoj



KRYETARI

Martin Marku

